

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-053/14

Prishtinë, 11 nëntor 2015

Në çështjen juridike të:

B.B.

Vidikovački Venac 67 17
11000 Beograd
Rakovica BG
Serbi

Pala ankuese/Paraqitësja e kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KPCC/D/R/215/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13301) të datës 21 gusht 2013, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 11 nëntor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B.B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/215/2013 të datës 21 gusht 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin 13301.**

2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/215/2013 i datës 21 gusht 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin 13301.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 23 gusht 2006 B.B. (në tekstin e mëtejme: paraqitësja e kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe ri-posedim të banesës (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar) që ndodhet në Prizren, në rrugën SPK Culjan, Dositejeva, Lamela 2, kati IV, nr. 34, me sipërfaqe prej 41.82 m².
2. Së bashku me kërkesën e saj ajo ka dorëzuar *inter alia* :
 - Vendimin e ndarjes nr. 02-272/98 të datës 19 qershor 1998, të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale e Komunës së Prizrenit (në tekstin e mëtejme: bartësi i të drejtës së ndarjes (BDN));
 - Kontratën mbi qeranë e pronës së kërkuar nr. 01-490/98 të datës 16 nëntor 1998, të lidhur ndërmjet paraqitëses së kërkesës dhe BDN-së. Bazuar në këtë kontratë paraqitësja e kërkesës ka qenë e obliguar të paguaj çmimin e qerasë në shumën prej 53,94 Dinarë;
 - Faturën nr. 0170, të lëshuar më 22 qershor 1998 nga Ndërmarrja Publike Distribucioni “Elektrokosmet”, Prizren. Kjo vërteton se paraqitësja e kërkesës kishte paguar shumën e caktuar të parasë për regjistrim si konsumator; dhe
 - Vërtetimin mbi marrjen e kërkesës nga abonenti nr. 1475, të lëshuar nga Kompania e Telekomunikimit “Telecom Serbia” sh.a. Beograd. Kjo dëftesë vërteton se paraqitësja e kërkesës ka bërë kërkesë për lidhje telefonike në rrjetin telefonik; dhe
 - Letërnjoftimin e paraqitëses së kërkesës nr. 221141, të lëshuar më 26 shkurt 1998.
3. Sipas Raportit të Verifikimit të datës 21 shkurt 2013, AKP ka verifikuar negativisht vendimin e lartpërmendur të ndarjes dhe kontratën për qiradhënien e pronës së kërkuar. Vendimi mbi ndarjen nuk është gjetur në arhiven e Qendres për Punë Sociale.
4. Më 27 gusht 2008, AKP ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur një njoftim në derën e pronës së kërkuar. Rezultoi se prona e kërkuar ishte zënë nga një person i panjohur.
5. Askush nuk ishte përgjigjur në kërkesë brenda afatit të paraparë prej 30 ditësh, prandaj kërkesa ishte trajtuar si e pakontestuar.

6. Më 21 gusht 2013 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/R/215/2013 ka refuzuar kërkesën. Në paragrafin 10, 32 në vendimin grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 18 tetor 2013 zbatohet posaçërisht ndaj kërkesës, theksohet se dokumentet që paraqitësja e kërkesës kishte dorëzuar, nuk ishin verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive. Komisioni konstaton se paraqitësja e kërkesës nuk ka dëshmuar asnjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar.
7. Më 3 dhjetor 2013, vendimi i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës. Ajo ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme më 27 dhjetor 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese).

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese thekson se KKPK në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.
9. Pala ankuese thekson se deklarimi i AKP-së se Sekretaria Ekzekutive nuk ka qenë në gjendje të verifikoi vendimin e ndarjes dhe kontratën mbi shfrytëzimin, mbi të cilat ajo pretendon se ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të pronës së kërkuar, nuk qëndron.
10. Ajo thekson se deklarata e bërë nga KKPK, e cila nuk përmban raporte konkrete të verifikimit, është e papranueshme.
11. Në ankesë pala ankuese bënë një prezantim detaj të dokumenteve që ajo ka dorëzuar për të vërtetuar të drejtën e saj të shfrytëzimit.
12. Pala ankuese propozon që Gjykata Supreme e Kosovës të pranon ankesën e saj dhe të bie një vendim ku konstaton se ajo ka të drejtë në ri-posedimin e banesës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor

13. Ankesa është paraqitur brenda afatit kohor 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.
14. KKPK e ka mbështetur vendimin e vet në faktin që Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kanë bërë verifikimin negativ të dokumenteve mbi të cilat pala ankuese e bazon kërkesën e saj për të drejtën e

shfrytëzimit. AKP-ja kish shkuar në Qendrën për Punë Sociale por dokumentet (vendimi mbi nadrjen dhe kontrata e qirasë) nuk ishin gjetur atje. Sekretaria Ekzekutive e KKKPK-së nuk ka qenë në gjendje të siguroj asnjë provë *ex officio* që do të mbështeste kërkesën e palës ankuese. Duke u mbështetur në këtë, KKKPK ka konstatuar se pala ankuese nuk ka dëshmuar asnjë të drejtë pronësore mbi pronën e kontestuar.

15. Ankesa e palës ankuese përsërit pretendimet e njëjta që ajo i kishte bërë para KKKPK-së. Asnjë provë e re nuk është dorëzuar me ankesën.
16. Pala ankuese nuk ka dorëzuar asnjë dokument apo provë tjetër që do të dëshmonte të drejtën e pretenduar të shfrytëzimit apo atë pronësore mbi pronën e kërkuar përkundër faktit se AKP ka kërkuar nga ajo sqarime dhe informata shtesë. Në fakt, ajo ka prezantuar vërtetimin nr. 1475 të datës 19 qershor 1998 dhe dëftesën nr. 0170 të datës 22 qershor 1998 me anë të së cilave i është dhënë leje palës ankuese që të bëjë lidhjen e linjës tokësore telefonike dhe energjinë elektrike në emër të palës ankuese. Megjithatë, ato dokumente gjithashtu janë verifikuar negativisht.
17. Gjykata Supreme konstaton se KKKPK ka marrë një vendim të drejtë e të mbështetur në një procedurë të plotë dhe korrekte. Ndryshe nga ajo që ankuesi ka thënë në ankesë, verifikimi i AKP-ës është i mjaftueshëm dhe i raportueshëm bindshëm. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe as shkelje të së drejtës materiale. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
18. Nga ajo që u tha më lartë e në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Kryetar i Kolegjit, EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it